

Ditari Natyres

**"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENiOR-A
"Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"**
Nr. 16 Viti i dytë i botimit Shtator 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Zbuloni thesaret e Jonit
- Kundër devijimit të lumit Vjosa/Aoos
- Trashëgimia natyrore e Parkut të Butrintit
- Trashëgimia natyrore e Parkut Detar të Karaburun Sazanit
- Njoftime

Zbuloni thesaret e Jonit

Në kuadër të projektit "Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare-Karaburun-Sazan, INCA në bashkepunim me Adriatic dhe SEEP (partneret lokal të projektit), gjatë këtij sezoni turistik në Gjirin e Vlorës ka zbatuar vitin e parë të Strategjisë së Komunikimit të hartuar për të rritur ndërgjegjësimin mbi vlerat dhe potencialin e zhvillimit të aktiviteteve të qëndrueshme turistike në Gjirin e Vlorës dhe veçanërisht në Zonën e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan në një grup të gjërë aktorësh. Në këtë kuadër janë prodhuar disa fletëplasje me një hartë demonstrative të aktiviteteve të mundshme të bazuara në natyrë që turistët mund të zhvillojnë dhe është shpërndarë në aktorë dhe grupe të ndryshme interesi, duke dominuar tek turistët e vendas dhe të huaj.



Një risi e veçantë ishte edhe prodhimi i fletëve të tavolinave për tu vendosur nën pjatë në restorante, të cilat janë shpërndarë në rreth 60 restorante/hotele përgjatë gjirit të Vlorës nga vullnetarët e organizatave SEEP dhe Adriatic.



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Kundër devijimit të lumit Vjosa / Aoos

Në fshatin Vovoussa, Janinë, Greqi, i cili ndodhet pranë burimit të lumit Vjosa/Aoos në zemër të Parkut Kombëtar Pindos, nga data 7 deri më 10 Gusht 2014, u zhvilluan aktivitete sensibilizuese me temë “KUNDER DEVIJIMIT TE LUMIT VJOSA/AOOS” drejt



Liqenit të Janinës. Në këto aktivitete merrnin pjesë banorët e zonës, përfaqësues bashkive Konicë dhe Zagori, të WWF Greqi, të Pindos Perivallontiki dhe shoqatave të tjera mjedisore greke, si dhe specialistë dhe profesorë të universiteteve greke. Në këto aktivitete ishte i ftuar edhe Kryetari i bashkisë Përmet Z. Gilbert Jaçe, Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës i përfaqësuar nga INCA dhe Shoqata Mjedisore “ÇAJUPI”.

Qëllimi i këtyre aktivitetëve ishte sensibilizimi dhe informimi i komuniteteve, si në Greqi ashtu edhe në

Shqipëri, mbi pasojat mjedisore, kulturore dhe social-ekonomike që mund të sjellë devijimi i Vjosës/Aoos.

Në fshatin Vovoussa u zhvillua këto katër ditë edhe një eko-kamping, koncerte, performancë teatrale, kinema verore, dy ekspozita fotografike dhe mbrëmje me muzikë popullore tradicionale. Të gjitha këto aktivitete janë një dëshmi që lumi

Vjosë/Aoos ka jetë dhe ne duhet ta mbrojmë atë. Në të ardhmen dy komunitetet e lumit Vjosë/Aoos, si në Greqi ashtu edhe në



Shqipëri, do të zhvillojnë aktivitete edhe më masive se ky për të ngritur edhe më fort zërin për mbrojtjen e jetës së tyre e cila është e lidhur drejt për drejt me lumin Vjosë/Aoos.

Trashëgimia natyrore e Parkut të Butrintit

Butrint, Sarandë - 27 Gusht 2014 - U organizua, në afërsi të Parkut Kombëtar të Butrintit, takimi i ekspertëve mjedisorë të projektit "Parqet Dinarike" me 30 përfaqësuesit lokalë nga administrata pyjore, qeverisja qendrore, komunat, bizneset e turizmit, arkeologë, përfaqësues nga shoqëria civile që punon në mbështetje të mjedisit, studiues, anëtarë të shoqatave të gjetisë dhe menaxhimit të ujërave. Takimi i sotëm për vlerësimin e përfitimeve përmes metodologjisë së WWF ka rëndësi të vecantë për njohjen e gjendjes aktuale në këtë park elitare të

Shqipërisë.

Kontributet e pjesëmarrësve ndihmuan në identifikimin e saktë të përfitimeve shumëplanëshe që vijnë nga larmia e jetës së egër në liqenin e Butrintit dhe veçanërisht Kanalit të Vivarit, shfrytëzimit të pasurive ujore për peshkimin dhe turizmin arkeologjik. Gërshetimi i vlerave arkeologjike me ato të monumenteve të natyrës së Parkut u cilesuan si trashëgimi unike që ndërton profilin e parkut të Butrintit. Ndërsa funksionimi i Komitetit të Menaxhimit të pasurive

Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2 të parkut të Butrintit si dhe presioni i industrisë së turizmit për të ndërtuar më tej në zonën e Ksamilit u ngritën si problemet kryesore nga pjesëmarrësit lokale.

Kryetari i Komunës Zarrë, z. Dhimitër Kote solli shembullin e mirë të kultivimit të kulturave bujqësorë në Komunën Zarrë si ajo e mandarinës që nuk shkon ndesh me bimësinë autentike të parkut dhe plotëson nevojat e fermerëve. “Ne po përpiqemi t’i ofrojmë turistit vendas e të huaj që viziton parkun e Butrintit” – thote Kote - “jo vetëm histori e arkeologji por edhe ekoturizëm me ushqimet e zonës dhe prezantojmë kulturën e njerëzve të saj”.

Ndërsa Genti Kromidha, ekspert i biodiversitetit në INCA (Instituti për Ruajtjen e natyrës në Shqipëri) theksoi se “Zonat e mbrojtura janë 16% të territorit të vendit dhe zona me rendesi kombëtare. Nga një analizë paraprake e të dhënave të grumbulluara në 10 parqe kombëtare dalin në pah sektorët e ekonomisë



kombëtare që përfitojnë më së shumti nga ekzistenca e zonave të mbrojtura. Përkthyer në përfitime të matshme në vlerë ekonomike apo jo, parqet kombëtare mbartin një vlerë të veçantë në sektorë të ekonomisë si: zhvillimi i turizmit, furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm, sigurimi i energjisë përmes lëndës djegëse dhe mbështetje për prodhimin blegtoral”.

Trashëgimia natyrore e Parkut Kombëtar Karaburun–Sazan

Orikum, Vlorë – 28 Gusht 2014 - Trashëgimia natyrore e Parkut Detar të Karaburun – Sazanit një pasuri unike për t’u eksploruar dhe ruajtur me kujdes nga brezat.

Orikumi ishte qyteti i radhës ku ekspertët e projektit “Parqet Dinarike” takuan banorët, përfaqësuesit e biznesit të turizmit, qeverisë lokale, specialistë të



ujërave dhe mbrojtjes së parkut, bletarë dhe peshkatore për të bërë vlerësimin e përfitimeve që i vijnë komunitetit nga Parku Kombëtar detar i Karaburun-Sazanit. Takimi i sotëm i eksperteve të WWF me grupet e interesit dhe bashkëpunimi në vijimësi me banorët lokale, synon mbledhjen e të dhënave që do të ndihmojë institucionet qendrore dhe vendore në krahasimin e informacioneve dhe përgjatë fazës së përgatitjes së planeve menaxhuese të parqeve.

Pjesëmarrësit ndihmuan në identifikimin e përfitimeve shumëplanëshe që vijnë nga larmia e jetës së egër në Parkun e Karaburun-Sazanit dhe shfrytëzimi i pasurive ujore për peshkimin, nga turizmi bregdetar dhe ai i natyrës si dhe përfimet nga kullotat për blegtorinë. Turizmi eksplorues i natyrës së Karaburunit me shpellat mahnitese, gjiret e virgjëra, Orikun e vjetër dhe ai i

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3 sporteve të zhytjes janë vetëm në fillimet e tyre por kanë mundësi të shkëlqyera zhvillimi që do të pasurojë dhe diversifikojë paketën turistike të zones së Vlorës.

Takimi nxorri në pah edhe problemet kryesore që ndeshën në të vetmin park detar të vendit si: peshkimi ilegal me lëndë plasese, shfrytëzimi intensiv nga disa biznese lokale të akuakulturës, funksionimi i dobët i Inspektoriatit të Peshkimit dhe mungesa e impianteve të përpunimit të ujërave të zeza. Ndërsa përfaqësuesit lokale nga biznesi i

turizmit përmendën vështirësitë burokratike që hasin në pajisjen me lejekalimi për grupet turistike nga baza ushtarake e Pashalimanit.

Në vijim të takimit, ekspertët e projektit “Parqet Dinarike” theksuan se nuk duhen lënë jashtë vëmendjes dhe promovimit vlerat kulturore të banoreve të zonës si polifonia labe, traditat apo gjetjet arkeologjike nënujore. Vetëm nderthurja e suksesshme e të gjithë elementeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore do të krijojë një profil të plotë të asaj që ofron parku detar i Karaburun-Sazanit.

NJOFTIME

- 1- Quality of EIA/SEAs of hydropower projects in seven Western Balkan countries (Croatia, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia, Kosovo, Macedonia and Albania)
<https://docs.google.com/document/d/1RZw8wJYP1wgwajyB6ZvrIE8vbGN4Yu9-uQE25Wbqkqc/edit?pli=1>
- 2- Opportunities of Study in Japan
http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/scholarship_2015.html
- 3- Japanese Government. Scholarship for 2015 (Research student)
http://www.mext.go.jp/a_menu/koutou/ryugaku/boshu/1346643.htm
- 4- Local Italian fishermen and diving community start collecting fishing nets for Healthy Seas
The more than 250 fishing boats based at the port of Ancona in Italy will start to collect their waste fishing nets for [Healthy Seas](#). This is one of the results of the successful meeting that took place in Ancona on Wednesday 23 July. Following the agreements made earlier this month, a collection point for these fishing nets has been set up in Ancona harbour as well. Healthy Seas and its partner De Fish Gear started their operational cooperation aiming to collect and reuse abandoned or discarded fishing nets in the Adriatic Sea this summer. The Port of Ancona established the first net collection point; this was done with the involvement of fishermen, divers, the local government and Ancona port authority, and researchers. In addition, diving activities with local divers are being planned around Ancona, both on shipwrecks and reefs nearby. The fishermen are willing to provide their boats, and so for the first time in the Healthy Seas initiative, they will be directly involved in ghost fishing net retrieval. Ancona is one of the most important ports of the Adriatic, for both fisheries and passenger traffic. The presence of more than 250 fishing boats larger than the national average, operating with bottom and pelagic trawl systems, makes this an ideal harbour for testing recovery actions of both derelict fishing gear and waste collected at sea during normal fishing activities. The first shipment of fishing nets collected in Ancona to the regeneration plant in Slovenia is foreseen in September. Similar activities are being explored in other Italian ports along the Adriatic coast.

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania